



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – e hapur e thjeshtuar mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**KRITERET PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN ME OBJEKT: “MATERIALE
KONSUMI PER OFICINEN TK”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV:	Dorashka pune	18141000-9
	Vegla dore	44511000-5
	Bulonë	44531400-5

Tipi i Proçedurës: E hapur, e thjeshtuar

VLERA E FONDIT LIMIT: **1.600.000 lekë pa TVSH, (një milion e gjashtëqind mijë)
lekë, pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **"Autoriteti Portual Durrës"**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, dhe në nenin 43 pika 2.a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i

2. Kapaciteti teknik:

2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe **nenin 40, pika 4** dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardet ISO si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, për menaxhimin e cilësisë

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/ certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën. Përbushja e standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të

siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqese Mostra ne Momentin e shpalljes fitues per Produktet e meposhtme:

1	Ilac Duarsh	cope	1
2	Solucion per larjen e motorit	bidon	25 lt
3	Set me 1000 kunja metalike	Cope	1 kuti

Argumentim: Mostrat jane të nevojshme në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të jetë I bindur në produktet qe Operatori Ekonomik oferton. Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në VKM nr 285, datë 19/05/2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 40 ”Kerkesa te vecanta per kontratat e mallrave” pika 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIM MBI MARRËVESHJEN KUADËR :

1.Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik, pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: lista e artikujve, specifikimet teknike, si dhe sasi të që pritet të furnizohen.

2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.

3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, duke pare edhe natyren e ketyre mallrave qe pergjigjen nevojave imediate te AK kjo mund t’i shkaktonte kosto shtesë, pasiguri, dhe vështirësi autoritetit kontraktor, si p.sh. mospërputhje të artikujve të dhënë ne bazë te rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

Afati i marreveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marreveshjes kuadër.

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara, **duhet të jenë të reja** dhe pa shenja përdorimi.

Në momentin e dorëzimit Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument që vërteton origjinën e mallit, si fatura tatimore, ekstrakt doganor nëse produktet janë blerë nga jashtë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përfshirur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Grupi i Specifikimeve Teknike: